


Te Drejtat e Studiuësve te Gjuhës Angleze

Edukimi është një e drejtë bazë për të gjithë fëmijet në United States. TAKTI qeveritar i vitit 2001, "Asnjë Fëmijë të mos Mbetet Mbrapa" (NCLB) ka shtuar të drejtat e tjera të rendesishme edukimi për studiuesit e gjuhës Angleze dhe prinderit e tyre. Ligjet qeveritare si, *NCLB, Titulli i VI i Aktit të të Drejtave Qytetare i vitit 1964* dhe Akti i vitit 1974 për Mundësitë e Barabarta të Edukimit, si dhe ligjet e shtetit të Massachusetts e pranojnë, që studentet të cilët janë të rinj në United States dhe që janë studiues të gjuhës Angleze kanë nevojë për ndihmë të posaçme. Ata duan ndihmë për të mesuar gjuhën Angleze dhe për të zotëruar standardet akademike. Kjo çështje e Pointers nënvizon disa nga keto të drejta nën ligjet qeveritare dhe shtetërore.



Ligjet qeveritare dhe shtetërore i përdorin termat "studentet me aftësi të kufizuara në Anglisht" (ose, studentet LEP), "studiues të gjuhës Angleze" (ose, ELLs), dhe "Studiues të Anglishtes" për të përshkruar të njëjtin grup studentësh. Massachusetts PIRC preferon termin "Studiues të gjuhës Angleze" sepse kjo e qartëson më mirë atë çfarë studentet po arrijnë –po zotërojnë një gjuhë të re, ndërsa janë duke mesuar të gjitha lëndet në shkollë dhe po behen anëtarë aktiv të shkollave të komuniteteve të tyre.

Cili quhet Studiues i Gjuhës Angleze?

Studiues të gjuhës Angleze (ELLs), që i referohet Aftësive të Kufizuara në Anglisht ose studente LEP, janë studente për të cilët Anglishtja nuk është gjuha e tyre amtare dhe të cilët nuk janë në gjendje të kryejnë detyrat e zakonshme të klases në gjuhën Angleze. Çdo rreth shkollor duhet të ketë një rrugë për të identifikuar, nëse një student është apo jo Studiues i Gjuhës Angleze. Sapo, ai identifikon se cilet janë ata, rrethi duhet të krijojë mundësitë e duhura në mënyrë që këta studente të marrin instruktimin e posaçem të hartuar për mesimin e gjuhës Angleze si dhe përbajtjen e lëndës në përputhje me ligjet dhe rregulloret.

Cilat janë të drejtat e fëmijës dhe prindit të fëmijës që studion Anglisht?

E drejta e një edukimi cilësor

- Fëmija juaj ka të drejtë të marrë të njëjten cilësi të lartë edukimi, bazuar në standardet, si gjithë të tjerët. Në Massachusetts, keto standarde edukimi janë nënvizuar në "Strukturat e Programit" të shtetit. Fëmija juaj do të mesojë Anglisht dhe lende të tjera si, arti i gjuhës Angleze, matematikë, shkencë, studime sociale dhe history në të njëjtin nivel akademik si gjithë studentet e tjerë.
- Fëmija juaj ka të drejtën të mesojë lende akademike të dhëna nga mesues, të cilët kanë një nivel të lartë kualifikimi në ato lende dhe që janë trajnuar të japin mesim për studentet që mesojnë Anglisht.
- Fëmija juaj ka të drejtë të marrë instruktim në gjuhën Angleze (e njohur si Anglishtja Gjuhë e Dytë, ose ESL), nga një instruktor me licensë të ESL, për të siguruar që fëmija juaj do të mesojë, degjojë, flase, shkruaj dhe lexojë Anglisht.

- Si një Studiues i Gjuhës Angleze, fëmija juaj do të marrë pjesë çdo vit në Provimin e Aftësive në Anglisht për Massachusetts (MEPA) për të vlerësuar përparimin e tij/te saj në mesimin e Anglishtes dhe do të informohet për rezultatet përkatëse.
- Fëmija juaj gjithashtu do të marrë pjesë në një provim vjetor mbareshitetor për të gjithë studentet, që quhet Sistemi i Provimit Gjithëpërfshirës për Massachusetts (MCAS), dhe që vlerëson përparimin e fëmijës tuaj në lëndët akademike. Ju do të merrni një raport të rezultateve të testit të fëmijës tuaj në gjuhën të cilën ju e kuptoni.

Për të mesuar më tepër për testet MEPA dhe MCAS, lutemi kontaktoni PIRC e Massachusetts për publikimin e "Studiuesve të Gjuhës Angleze dhe Provimit Shtetërore". Procedura e këtyre provimeve gjendet në internet në www.doe.mass.edu/mcas/cal/html dhe në shkollën e fëmijës tuaj.

E drejta e Prindit për informacion

- Ju duhet të merrni informacion për përparimin e fëmijës tuaj nga shkolla, në të njëjten rrugë dhe aq shpesh si të gjithë prinderit e tjerë, në gjuhën që ju e kuptoni, në "mundësinë maksimale të shtrirë". Ky informacion përfshin kartën e raportit të studentit, raportin e përparimit dhe Raportin e Prindit/Kujdestarit (G.L. c. 71A Pjesa 7; shih gjithashtu Titulli i VI.)

- *Ne qofte se ju i kerkoni ato*, Drejtori i shkolles duhet te sigurohet qe ju merrni manualin e shkolles dhe codet e sjelljes se qytetit ne gjuhen tuaj ametare. (E Drejta e Massachusetts ne Rregulloren e Mundesive te Barabarta per Edukim, 603 CMR 26.08(2)).
- Ne se femija juaj eshte percaktuar me “Aftesi te Kufizuar ne Anglisht” ose si nje Studiuues i Gjuhes Angleze, shkolla e femijes tuaj duhet t’ju njoftoje ju per:
 1. Nivelin e femijes tuaj ne degjim, te folur, lexim dhe shkrim Anglisht, ne krahasim me studiuuesit e tjere te gjuhes Angleze.
 2. Programin e Rekomanduar te shkolles per femijen tuaj. Shumicat e qyteteve afrojne Sheltered English Immersion. (Shiko me poshte shpjegimin per Sheltered English Immersion.) Shkolla duhet te shpjegoje, se si funksionon ky program, si do te ndihmoje ky program femijen tuaj per te mesuar Anglisht, dhe si do te permbushë femija juaj nevojat e edukimit te tij/saj.
 3. Sa kohe pritet te zgjase programi.
- Prindi duhet te marre njoftim, qe femija e tij eshte percaktuar si nje Studiuues i Gjuhes Angleze, brenda 30 diteve te fillimit te vitit shkollor. Per femijen qe fillon shkollen pasi shkolla ka filluar, shkolla duhet te njoftoje prindin, brenda dy javeve, ne qofte se femija eshte vendosur ne nje program per studiuuesit e gjuhes Angleze.

E drejta e prindit per te refuzuar programin e studiuvesve te gjuhes Angleze

- Ne se ju nuk deshironi qe femija juaj te jete ne programin e studimit te gjuhes Angleze, ju keni te drejten te refuzoni rregjistrimin ne program, si dhe te drejten qe te largoni femijen tuaj nga ky program ne cdo kohe.
- Ne se ju vendosni, qe femija juaj te qendroje ne nje klase te edukimit te pergjithshem, atehere rrethi i shkolles duhet ti siguroje femijes tuaj ndihme akademike dhe gjuhe Angleze, ne menyre qe femija te kete mundesi te mesoje Anglisht. Gjithash-

tu shkolla duhet ti siguroje femijes nje mesues te kualifikuar, qe jep mesim per studiuuesit e gjuhes Angleze.

E drejta e femijes ne kontrollin akademik

- Kur femija juaj behet i afte ne gjuhen Angleze (bazuar ne provimet mbareshtetore dhe informacione te tjera) dhe le programin e studiuvesve te gjuhes Angleze, rrethi duhet te kontrolloje perparimin akademik te femijes tuaj per dy vjet, si dhe te siguroje sherbime te tjera edukimi ne gjuhen Angleze, ne se femija ka nevojë.

Te drejtat e studenteve me paaftesi

- Programet e studiuvesve te gjuhes Angleze, per studentet me paaftesi, duhet te permbushin kerkesat e Programit te Edukimit Individual te tyre (IEP). Per studentet me nje IEP ose Plan 504, instruktimi duhet te jete ne gjuhen e tyre ametare, dhe rrethi duhet te pajtohet me IEP ose Planin 504. Nuk kerkohet “waiver”.
- Dokumentat shkollor te femijeve me paaftesi, te cilet jane studiuues te gjuhes Angleze, duhet te perkthehen ne gjuhen ametare te prinderve te tyre. Ne te gjitha takimet per planin e edukimit, duhet te kete perkthyes te afte ne gjuhen e prinderve, ne se eshte e nevojshme, qe prindi (it) te marri pjese ne kete takim.

E drejta e femijes per ndihma speciale dhe sherbime te tjera

- Femija juaj ka mundesine te marre sherbime te ndihmes akademike si, drejtim dhe keshillim, ne gjuhen e pare tij/te saj.
- Femija juaj duhet te kete te drejte te barabarte te hyje ne te njejtat programe jo akademike dhe aktivitete jashte programit, te cilat jane ne dispozicion te te gjithë studenteve. Prinderit duhet te informohen rreth ketyre aktiviteteve ne gjuhen qe ata e kuptojne.
- Studentet ELL, nese kualifikohen, kane te drejte te marrin sherbime speciale edukimi si, sherbim i Titullit te I dhe edukim profesional, si dhe te marrin pjese ne klase speciale dhe te avancuara.

Cfare programesh jane ne dispozicion te studiuvesve te gjuhes Angleze?

Ligji i Massachusetts referon programet si me poshte:

Koncentrim i Mbrojtur i Anglishtes (SEI): Ligji i Massachusetts kerkon qe te gjithë studentet, te cilet jane studiuues te gjuhes Angleze te edukohen ne programet e koncentruara te mbrojtura te Anglishtes (EI). Ne klasat SEI, pothuajse te gjithë materialet e instruktimit dhe librat jane ne Anglisht. Programet SEI kane dy pjese. Nje pjese quhet “instruktim i permbajtjes i mbrojtur,” i cili perdor posacerisht Anglishten e adaptuar, per ta bere instruktimin me te kuptueshem per studentet qe mesojne Anglisht. Pjesa tjeter, “instruktimi i gjuhes (Anglishtja si Gjuhe e Dyte, ose ESL),” ndihmon studentet ELL te zhvillojne aftesite ne te folur, degjim, lexim dhe shkrim ne Anglisht. Balanca midis instruktimit ESL dhe instruktimit akademik ne Anglisht ndryshon kur studentet behen me te afte ne gjuhen Angleze. Studentet qe sapo fillojne te mesojne Anglisht duhet te marrin me teper instruktim cdo dite ne ESL, se studentet, te cilet pothuajse po behen te afte ne Anglisht.

Edukimi Dygjuhesor ne Dy-Rruge : Studentet qe mesojne Anglisht dhe studentet te cilet kane si gjuhe ametare Anglishten, mesojne se bashku ne te dy gjuhete. Instruksioni dhe librat jane ne te dyja gjuhete e studentit, te paren dhe te dyten. Ne qofte se rrethi afron nje program dygjuhesor ne dy-rruge, prindi i studiuuesit te gjuhes Angleze, mund te vendosi qe femija e tij/i tij te marre pjese ne nje program te tille pa qene nevoja te aplikojë, apo refuzojë ate.

Edukimi Dygjuhesor (TBE): Permbajtja e instruktimit jepet ne gjuhen ametare te femijes, ndersa ai/ajo eshte duke mesuar Anglisht. Gjithashtu femijet e kane ne dispozicion instruktimin dhe ne gjuhen Angleze si gjuhe e dyte (ESL). Pasi aftesite e studentit ne Anglisht rriten, ata fillojne te marrin instruktim ne gjuhen Angleze. Per te refuzuar pjesemarrjen ne kete program kerkohet nje document qe quhet “waiver” dhe qe lejon studentet te marrin pjese ne “metodologji te tjera te njohura te pergjithshme qe lejon ligji.” (Lutemi, shikoni informacionin ne lidhje me kete dokument ne faqen 3.)

Kushti i “refuzimit”: Prinderit, te cilet nuk deshironje, qe femijet e tyre te vendosen ne klase te adaptuara per studiuuesit e Anglishtes, mund te “refuzojne”, dhe femijet e tyre do te vendosen ne klase te edukimit te pergjithshem. *Shkollat duhet te kontrollojne perparimin e studenteve te cilet refuzojne keto klase dhe tu sigurojne atyre ndihme ne mesimin e Anglishtes.*

E drejta e prinderve per tu perfshire

- Si prind i nje student, i cili po meson Anglisht, shkolla the rrethi duhet tu jape ju shume mundesi per te komunikuar me mesuesit e femijes tuaj, si dhe te merrni pjese ne rruge te ndryshme.

Si te kerkosh nje dokument, ne menyre qe femija im te marre edukim dygjuhesor?

Prinder individuale te studenteve te ELL mund te kerkojne nje dokument "waiver" ne se duan, qe femijet e tyre te marrin instruktim ne klasa te edukimit dygjuhesor (ndonjehere referohet si Edukim Dygjuhesor Tranzicional, ose TBE) ose disa programe te tjera te aprovuara. Me poshte pershkruhet se si ky process funksionon:

- Cdo vit, prindi ose kujdestari duhet te aplikojte per "waiver". Per kete studentet duhet te vizitojne shkollen dhe te japin miratimin e tyre me shkrim. Ne kete vizite, prinderit duhet te marrin nje "pershkrim te plote ne gjuhen, te cilen ata e kuptojne" te programeve te ndryshme ne dispozicion te femijeve te tyre. Rrethi merr vendimin final ne kete kerkese "waiver".
- **Per studentet 10 vjec e me lart**, pasi prindi ka bere kerkesen, drejtori i shkollës dhe mesuesit duhet te konfirmojne, qe eshte "besimi" i tij, qe nje program tjetër do te plotesoje me mire nevojat e studentit.

Ne nje shkollë, ku 20 ose me shume studente te se njejtës gjuhe dhe klase, marrin "waiver", kerkohet, qe te afrohen "klasa ku mesohet Anglisht dhe lende te tjera nepermjet teknikave dygjuhesore te edukimit ose metodologji te tjera te njohura te pergjithshme qe lejon ligji." (G.L. c. 71A. §5) Shkollat qe kane me pak se 20 studente ne nje klase me "waiver" mund te afrojne nje klase te tille. Ne qofte se shkolla nuk afron nje klase te tille, ajo duhet te lejojte studentet, te cilet kane nje "waiver" te transferohen ne nje shkollë tjetër publike qe ka nje klase dygjuhesore.

- **Per studentet nen moshen 10 vjec**, eshte me e komplikuar. Rrethi duhet te pranoje "waivers" sipas ketyre konditave:

- 1) Studenti qe ka qene ne nje klase te gjuhes Angleze te pakten per 30 dite kalendarike; dhe
- 2) Stafi i shkollës sqaron me shkrim, qe studenti jo vetem nuk flet dhe kupton Anglisht, por ai ka nevojte per ndihme speciale, dhe kjo ben te domosdoshme afrimin e nje programi tjetër.

Dokumenti i mesiperme me shkrim duhet te perfshihet ne dokumentat e studentit; dhe te dy, kryeinspektori dhe drejtori i shkollës duhet te firmosin dokumentin.



Per te mesuar me teper, se si te ndihmoni edukimin e femijes tuaj, kontaktoni Massachusetts PIRC pagesa-falas ne 1-877-471-0980.
CE}^cæ;/^c^A^cæ, cæ-/[b] ^A} ää@ { ^Ac^A^~ [} ä \^A } ^AcE} *ß • cEÁ Ú]æ}ü • cÁ ä @ ^A Portugalisht.

Cfare duhet te beje prindi?

Me poshte jane renditur, cfare mund te beni ju si prind ose kujdestar per te ndihmuar femijen tuaj, qe te perparojte ne shkollë:

Kerko, qe shkolla te dergoje te gjitha raporte t ne gjuhen tuaj ametare, ne se deshironi.

Bisedo me prinder te tjere, femijet e te cileve kane ndjekur te njejtën shkollë ose programe. Kerko prej tyre si funksionojne programe te tjera dhe si ju mund te perfshiheni sa me mire ne keto programe.

Pyet, per te pare se cfare po meson femija juaj dhe si po e merr mesimin ne Anglisht. Vizito klasat e femijes tuaj gjate dites shkollore per te pare cfare ai/ajo po meson.

Pyet, ne se femija juaj merr instruktim ne gjuhen Angleze, e njohur zakonisht si ESL, dhe ne se merr, sa shpesh? Eshte mesuesi i gjuhes Angleze i licensuar ne menyren e duhur?

Pyet shkollën , ne se mesuesi i femijes tuaj ka kualifikim te larte per te dhene artet e gjuhes Angleze , lexim, matematike dhe shkence. Pyet, ne se mesuesi eshte i rrjedhshem ne Anglisht , dhe ne se eshte i trainuar per te patur aftesite e domosdoshme, ne menyre qe te jape mesim per studentet qe mesojne Anglisht.

Mos lejo, qe paafesia juaj per te folur Anglisht te behet pengese per te bere pyetje. Edukimi i femijes tuaj eshte shume i rendesishem. Veni ne dijeni shkollën e femijes tuaj, qe ju keni nevojte per nje perkthyes. Ju mund te sillni me vete nje avokat ne takimet me shkollën.

Planifiko te marresh pjese ne takime dhe aktivitete shkollore me nje perkthyes. Ky person mund te jete nje shok.

Ne se femija juaj eshte ne shkollë te mesme, pyet shkollën se kush eshte niveli i diplomimit per studentet ne programin e rekomanduar. Pyet, ne se femija juaj po merr kredite per te gjitha klasat.

Ne se ju mendoni se femija juaj mund te mos diplomohet, pyet per ndihme akademike shtese dhe/ose nje program tjetër, i cili do te pregatise femijen tuaj per tu diplomuar.

Ligji qeveritar mbeshtet ate, qe prinderit duhet te jene mbrojtës te fuqishem te femijeve te tyre dhe duhet te ndihmojne shkollën per ta permiresuar ate. Pyet rrethin ose shkollën, per te gjetur rruge, per tu lidhur me prinder te tjere, te cilet punojne per te permiresuar shkollën, si p.sh. ne Konsultimet e Keshillimit te Prinderve . Merr pjese ne organizata te bazuara ne komunitet, te cilat punojne per te avancuar edukimin e studiuesve te gjuhes Angleze dhe te studenteve minoritare.

Perveç te drejtave te renditura ne **Pointers**, ligji qeveritar siguron te tjera zgjidhje te rendesishme per te gjithë prinderit. Per shembull; prinderit, femijet e te cileve jane ne shkollë te n je niveli jo te kenaqshem mund te kene te drejten te zgjedhin nje shkollë tjetër, ose te marrin mesim privat falas per femijet e tyre. Massachusetts PIRC mund te dergoje dokumenta falas dhe te thjeshte per tu kuptuar ne Anglisht, Spanjisht dhe Portugisht.

Burimet Falas te PIRC per Massachusetts

PIRC e Massachusetts siguron prinderit, shkollat dhe organizatat me trainime, informacione dhe ndihme teknike per te ndihmuar perpjekjet e femijeve, qe te perparojne ne shkollat. Qellimi yne eshte te ndihmoje prinderit dhe familjet, qe te kuptojne se si te ndihmojne arrijtet akademike te femijeve te tyre, si dhe te ndihmoje familjet dhe shkollat per te ndertuar nje bashkepunim te fuqishem me qellim permiresimin e edukimit. Publikimet e meposhteme plotesojne informacionin ne lidhje me kete ceshtje te **Pointers**

VENDI i Prinderve ne Pointers

*i` Gh i X] i Yg] h` Y` ; ^ i \ Yg` 5b [` Yn Y` X \ Y` Dfc j] a Yh` Y` G \ h Y] h
i` 8 i _ Y D i b i U f` a Y G \ _ c `` Y b` H i U`
i` ? U f h U h` Y` F U d c f h] h` h` Y` G \ _ c `` Y g
i` G \ Y f V] a Y` 9 X i _] a]` G \ h Y g Y` g j d U g` B 7 @ 6 ``*

VENDI i Prinderve ne 6 i` Yh] bg

*i` F U d c f h]` D f] b X Y f] h# ? i` X Y g h U f] h` d Y f` A 7 5 G. ` b` Y` \ U f h`
d` U b
i` A Y g] a ` d f] j U h` Z U` U g` a V Y g \ h Y h i f` b` Y` í 5 g b` Y` : Y a]` Y` h` Y`
a c g` A V Y h` Y h` A V f U d U í*

Te gjitha publikimet jane ne dispozicion ne Anglisht, Spanjisht dhe Portugalisht. Ky Pointers dhe Pointers ne "Studiuesit e Gjuhes Angleze dhe Provimet e Shtetit" jane gjithashtu ne dispozicion ne Shqip, Cape Verdean Creole, Chinese, Haitian Creole, Russian, Somali, dhe Vietnamese. Te gjitha publikimet jane ne internet ne www.masspirc.org. Ne qofte se doni, mund te kerkoni kopie te printuara te ketyre publikimeve ose ndihme telefonike ne Anglisht, Spanjisht dhe Portugalisht. Lutemi, telefononi Mass PIRC's, pagesa-falas, linja e ndihmes ne 1-877-471-0980.

Departamenti i Massachusetts per Burimet e Edukimit Elementar dhe Dytesor (Mass. DESE)

Website i Mass.DESE eshte www.doe.mass.edu. Dokumentat ne Website rifreskohen here pas here dhe titujt e vendet e sakta mund te ndryshojne. Rruga me e lehte per te hapur nje document eshte duke shkruar titullin ne vendin e kerkimit.

- **Procedurat e Rishikimit te Programit te Koordinuar: Pa-keta e Informacionit per Shkollat e Rrethit, Edukimi i Studiuesve te Anglishtes ne Shkollat Publike, M.G.L. Kapitulli 71A.** Ky dokument rendit ligjet dhe rregullat qeveritare e shteterore, sipas te cilave shkollat duhet te perputhen ne edukimin e studiuesve te gjuhes Angleze. Internet ne www.doe.mass.edu/pqa/review/cpr/instrument/chapter71A.doc.
- **Nivelet e Aftesise se Gjuhes Angleze dhe Rezultatet per Studiuesit e Gjuhes Angleze.** Ky dokument nenvizon njohurite dhe aftesite qe studentet pritet te fitojne ne gjuhen Angleze, ne kater fusha te saj, degjim, te folur, lexim dhe shkrim. Internet ne <http://www.doe.mass.edu/mcas/mepa/benchmark.html>.
- **Strukturat e Programit te Massachusetts.** Keto struktura (ose "standarde") pershkruajne, se cfare duhet te dine dhe te jene ne gjendje te bejne studentet e shkollave publike te Massachusetts ne tete lende akademike kryesore ne klasa te intervaleve te ndryshme. Internet ne www.doe.mass.edu/frameworks/current.html.
- **Raportet dhe Udhezimet e Prinderve/Kujdestareve MEPA.** Ky udhezim, qe eshte ne dispozicion ne Anglisht dhe 10 gjuhe te tjera, ka per qellim te ndihmoje prinderit ne rishikimin e rezultateve MEPA te femijeve te tyre, si dhe te kuptojne se si jane raportuar piket. Udhezimi shton informacionin e siguruar nga Raporti i Prinderve/Kujdestareve MEPA. Internet ne <http://www.doe.mass.edu/mcas/mepa/pg/>

- **Pyetje dhe Pergjigje ne lidhje me Kapitullin 71A: Edukimi i Gjuhes Angleze ne Shkollat Publike.** Internet ne http://www.doe.mass.edu/ell/chapter71A_faqs.pdf.
- **Oraret per Testin MCAS dhe MEPA.** Rifreskohen cdo vit dhe publikohen ne internet ne www.doe.mass.edu/mcas/cal.html.

Ndihma Telefonike Shtese

Federata per Femijet me Nevoja Speciale, Trainimet e Prinderve dhe Qendra e Informacionit, sigurojne ndihme falas ne Anglisht, Spanjisht dhe Portugalisht per familjet e femijeve me paaftesi, nepermjet grupeve te studimit, materialeve te shkruajtura (internet ne www.fcsn.org/pti) dhe telefon, pagesa falas, ne 800-331-0688.

Per pergjigje te pyetjeve ne lidhje me MCAS dhe MEPA, telefono Mass. DESE Informacion Emergjent per Prinderit ne 781-338-6970 ose, pagesa falas, ne 866-622-7220. Pyetjet mund ti beni ne email ne mcas@doe.mass.edu. Gjithashtu, mund te kerkoni kopie te shkruara te materialeve DESE.

Per pyetje ne lidhje me rregullat e MCAS dhe MEPA, kontaktoni Mass. DESE me telefon ne 781-338-3625, ose email dwienner@doe.mass.edu.

Per pyetje ne lidhje me identifikimin, vleresimin dhe vendosjen e studiuesve te gjuhes Angleze, kontaktoni Zyren e Pervetesimit te Gjuhes Angleze dhe Arrijteve Akademike te Mass. DESE ne 781-338-3518, ose me email ell@doe.mass.edu.



Pointers

Parents' PLACE Pointers was originally developed under Grant #U310A030443 awarded by the U.S. Department of Education, Ofyce of Innovation and Improvement. The funds to update and disseminate this issue of Pointers were made available through Grant #U310A060075 from the U.S. Department of Education, Ofyce of Innovation and Improvement, Parental Information and Resource Center program, Grant #84.310A. The views and opinions herein do not necessarily reflect those of the U.S. Department of Education.

We encourage copying of this newsletter to distribute to parents and families. Permission is granted to reprint this publication in whole or in part. Please credit *Parents' PLACE Pointers*, Massachusetts PIRC, Federation for Children with Special Needs, and contact us at masspirc@fcsn.org to indicate the number of copies disseminated.

È Federation for Children with Special Needs, 1209.

Ceshtja **Pointers** eshte shkruar nga Janet Vohs, staf i Mass PIRC, me ndihmen e Debbie Zacarian, Ed.D., Drejtor, Qendra per Edukimin ne Gjuhen Angleze (CELE), program i Bashkepunimit te Edukimit per Hampshire, Northampton, MA. Mass PIRC falenderon stafin legal te Departamentit te Massachusetts per Edukimin Paresor dhe Dytesor, per rishikimin dhe rregullimet qe kane bere.